

Skender LUTFIU

NDIKIMI I KOMITETIT MBROJTJA KOMBËTARE E KOSOVËS NË MARRËDHËNIET SHQIPTARO-JUGOSLLAVE

Komiteti i Kosovës duke ndërkombëtarizuar çështjen e shqiptarëve në Mbretërinë SKS dhe pasqyruar dhunën dhe terrorin shtetëror që ushtrohej ndaj tyre, nxiste Beogradin zyrtar të akuzonte Tiranën për mbështetjen që ua jepte Komitetit të Kosovës dhe kështu acaroheshin raportet ndërshtetërore ndërmjet Shqipërisë dhe Mbretërisë SKS.

Kosova dhe viset e tjera shqiptare të Maqedonisë dhe të Malit të Zi u ripushtuan gjatë vitit 1918 nga forcat serbe dhe malazeze. Në dhjetor kur u formua Mbretëria Serbo-Kroato-Slllovene, (më tej vetëm SKS) ato u bënë pjesë e saj, pa vullnetin e shqiptarëve, që përbënin shumicën në këto vise. Në të njëjtin vit, në Shkodër u themelua Komiteti Mbrojtja Kombëtare e Kosovës* (më tej vetëm Komiteti i Kosovës), qëllimet e të cilit ishin lufta

* Komiteti “Mbrojtja Kombëtare e Kosovës”, u formua në Shkodër më 1 maj 1918, me kryetar Hoxhë Kadri Prishtinën. Ky Komitet ishte organizatë politike me parime demokratike dhe organi kryesor i lëvizjes patriotike të popullit shqiptar në Kosovë dhe viset e tjera të pushtuara nga Mbretëria SKS. Qëllimet kryesore të tij ishin ruajtja e pavarësisë së Shqipërisë dhe demokratizimi i saj, çlirimi i Kosovës dhe viset e tjera dhe bashkimi me Shqipërinë etj. Për më tepër për veprimtarinë e përgjithshme të Komitetit të Kosovës shih në: Zamir Shtylla, “Rreth krijimit dhe veprimtarisë së Komitetit Mbrojtja Kombëtare e Kosovës në vitet 1918-1920”, *Studime historike*, Nr.3, Tiranë: 1986; Lush Culaj, *Komiteti Mbrojtja Kombëtare e Kosovës, 1918-1924*, Prishtinë: Instituti Albanologjik i Prishtinës, 1997; Lush Culaj, *Shqipëria dhe problemi kombëtar, 1918-1928*, Prishtinë: Instituti Albanologjik i Prishtinës, 2004; Marenglen Verli, *Shqipëria dhe Kosova historia e një aspirote*, Vëll. II, Tiranë: Botimpex, 2007, 294-295; Miranda Vickers, *Shqiptarët një histori moderne*, Tiranë: Bota Shqiptare, 2008, 148; Hakif Bajrami, *Komiteti Mbrojtja Kombëtare e Kosovës dhe qeveritë e Tiranës për krimet serbe ndaj shqiptarëve, 1918-1941*, Prishtinë: pa botues, 2008, 52-92; Emine Arifi-Bakalli, *Çështje nga historia moderne dhe bashkëkohore shqiptare*, Prishtinë: Instituti Albanologjik, 2013, 43-56; Xheladin Shala, *Hasan Prishtina, vështrim i shkurtër atdhetarie*, Prishtinë: Instituti Albanologjik, 2014, 108-110, “Komiteti Mbrojtja Kombëtare e Kosovës (KMKK) (1918-1924)”, *Fjalori Enciklopedik i Kosovës*, Nr. I, Prishtinë: 2018, 827, Beqir Meta et.al,

kundër kufijve të përcaktuar në Londër (1913); çlirimi i territoreve shqiptare të pushtuara nga serbo-malazezët dhe bashkimi i tyre me Shqipërinë.

Bërthama e programit të Komitetit të Kosovës ishte rivendosja e pavarësisë së Shqipërisë dhe mbrojtja e tërësisë territoriale. Me programin e tij kombëtar dhe demokratik, Komiteti i Kosovës ushtroi ndikim të rëndësishëm në jetën politike në Shqipëri dhe në marrëdhëniet e saj me shtetet fqinje, konkretisht me Mbretërinë SKS. Veprimtaria e Komitetit të Kosovës u shtri në shumë qytete të Shqipërisë**, të Kosovës dhe viseve të pushtuara.*** Po ashtu u hartua edhe një rregullore e brendshme për organizimin dhe veprimtarinë sa më të mirë të Komitetit.¹ Duhet theksuar se degët e Komitetit të Kosovës, veprimtarinë e tyre në Shqipërinë politike e zhvillonin në mënyrë legale, në dallim nga viset e pushtuara, ku veprimtaria e këtij komiteti zhvillohej në mënyrë ilegale.² Kjo ishte arsyeja që letërkëmbimi i Këshillit Qendror me degët në Kosovë dhe në viset e tjera të pushtuara bëhej jo rrallë i koduar (me shifër).³

Rreth Komitetit të Kosovës u grumbulluan intelektualë dhe entuziastë nga të gjitha trojet shqiptare. Ndërsa, Këshillin Qendror e përbënin 7 anëtarë, të cilët zgjidhnin strukturat e Komitetit (kryetarin, nënkryetarin, sekretarin dhe arkëtarin). Duhet të theksohet fakti se kryetar gjatë gjithë kohës së ekzistencës së Komitetit të Kosovës ishte Hoxhë Kadri Prishtina*, kurse sekretar ishte Bedri Pejani. Secili nga anëtarët kishte një

Historia e shqiptarëve gjatë shekullit XX, Vëllimi II, Tiranë: Akademia e Studimeve Albanologjike-Instituti i Historisë, 2019, 606-624 etj.

** Degët e Komitetit të Kosovës në Shqipëri u formuan në këto qytete: Shkodër (selia e këtij komiteti), Tiranë, Durrës, Elbasan, Peshkopi etj. Shih në: Meta et.al, *Historia e shqiptarëve*, 609.

*** Degët e Komitetit të Kosovës u formuan dhe ushtruan veprimtarinë e tyre në këto qytete të Kosovës: Gjakovë, Prizren, Prishtinë, Ferizaj, Gjiilan, Pejë, Rahovec, Vushtrri etj. Ky komitet kishte degë edhe në Shkup. Shih në: Meta et.al, *Historia e shqiptarëve*, 609.

¹ Agjencioni Shtetëror i Arkivave të Kosovës (më tej: ASHAK), Fondi. (më tej: F.) Komiteti Mbrojtja Kombëtare e Kosovës, Sigla II, Mikrofilmi.708-263, fl. 210-214. Rregullore e Organizimit të Përbrendshëm të Komitetit "Mbrojtja Kombëtare e Kosovës".

² Lush Culaj, *Shqipëria dhe problemi kombëtar, 1918-1928*, Prishtinë: Instituti Albanologjik i Prishtinës, 2004, 35-36.

³ Beqir Meta et.al, *Historia e shqiptarëve gjatë shekullit XX*, Vëllimi II, Tiranë: Akademia e Studimeve Albanologjike-Instituti i Historisë, 2019, 610.

* Kadri Prishtina ose Hoxha Kadri (1878-1820 janar 1925), ishte figurë e shquar e kombit shqiptar, klerik mysliman, dijetar, diplomat, publicist, jurist etj. Shkollimin fillor e kreu në Prishtinë, të mesmin në Shkup, ndërsa në Stamboll e kreu Shkollën e Lartë Pedagogjike dhe më pas shkollën e njohur "Fatih", ku diplomoi me rezultate të shkëlqyera. Më 1904 u internua nga autoritetet turke në Sinopë, por, megjithatë asnjëherë nuk e ndali veprimtarinë e tij në të mirë të çështjes kombëtare. Më 1915 në Durrës themeloi komitetin me emrin

detyrë të veçantë, si Hysni Curri merrej me organizimin e forcave të armatosura, Bedri Bejani punoi në marrëdhëniet me jashtë të Komitetit të Kosovës, Sali Nivica, drejtonte gazetën “Populli” etj. Ndërsa, në kuadër të këtij komiteti kanë vepruar patriotë të njohur, si: Hasan Prishtina, Bajram Curri, Azem Bejta, Beqir Vokshi, Aqif Elbasani, Ragip Kaja (Begolli), Sejfi Vllamasi, Elez Isufi, Sadik Rama, Bajram Deklani, Ibrahim Gjakova, Hasan Ferri, Qazim Bakalli, Halim Gostivari, Tafil Boletini, Niman Ferizi etj.⁴

Që nga themelimi i tij, Komiteti i Kosovës, binte ndesh me politikën e Mbretërisë SKS, e cila po ashtu ishte themeluar në të njëjtin vit. E themi këtë ngase që në pikën e parë të programit të komitetit kërkohej bashkimi i Kosovës dhe i veseve tjera shqiptare (Shkup, Kumanovë, Preshevë, Tetovë, Gostivar, Kaçanik, Ferizaj, Gjilan, Prishtinë, Vushtrri, Mitrovicë, Pazar i Ri, Rozhajë, Pejë, Gjakovë, Plavë, Guci, Prizren⁵), me Shqipërinë, të cilat ishin ripushtuar nga mbretëria SKS. Ndërsa, pikat e tjera të programit themeltar të Komitetit të Kosovës parashihnin: 1. Protestimin kundër politikës antishqiptare që ndiqte Beogradi zyrtar ndaj popullit shqiptar në Kosovë dhe në viset e tjera shqiptare, dhe 2. Zgjedhja dhe dërgimi i një delegacioni në Konferencën e Paqes në Paris, për të mbrojtur me sukses çështjen shqiptare në arenën ndërkombëtare, në rrugë zyrtare e jashtëzyrtare.⁶

Një tjetër arsye e përplasjeve diplomatike ndërmjet Tiranës dhe Beogradit ishte edhe pjesëmarrja e krerëve të Komitetit të Kosovës në qeverinë e Lushnjës dhe më pas. Njëri ndër ta ishte kryetari i Komitetit të Kosovës, Hoxhë Kadri Prishtina, që në qeverinë e Lushnjës mori detyrën e

“Komiteti i Fshtë”, ndërsa më 1 maj 1918, në Shkodër u themelua Komiteti “Mbrojtja Kombëtare e Kosovës”, kryetar i së cilit u zgjodh Kadri Prishtina. Ka mbajtur poste të larta shtetërore, si: ministër i Drejtësisë, në qeverinë e Sylejman Delvinës, pastaj disa herë ka mbajtur mandatin e deputetit në Parlamentin shqiptar etj. Për më tepër shih në: *Gjeneral G.F. Phillips dhe Komiteti “Mbrojtja Kombëtare e Kosovës”*, Dokumente historike nga Arkivat Britanike, 1913-1921, përgatitur për botim nga Ethem Çeku dhe Bejtulla Destani, Tiranë: Instituti i Çështjeve Kombëtare-Tiranë dhe Qendra për Studime Shqiptare-Londër, 2015, 457-458; “Prishtina Kadri Lutfulla”, *Fjalori Enciklopedik Shqiptar* Nr. 3, Tiranë: 2009, 2097-2098, etj.

⁴ Meta et.al, *Historia e shqiptarëve*, 607-608; Kastriot Dervishi, *Historia e shtetit shqiptar, 1912-2005*, Organizimi shtetëror, jeta politike, ngjarjet kryesore, të gjithë ligjvënësit, ministrat dhe kryetarët e shtetit shqiptar, Tiranë: Shtëpia Botuese 55, 2006, 88.

⁵ Arkivi Qendror Shtetëror i Republikës së Shqipërisë, (më tej: AQSh), Fondi (më tej: F.): 446, Viti (më tej: V.) 1918, Dosja (më tej: D.) 1, fl.1. Programi themeltar i Komitetit “Mbrojtja Kombëtare e Kosovës”. Shqipëri: 1 maj 1918.

⁶ AQSH, F.446, V. 1918, D. 1, fl.1. Programi themeltar i Komitetit “Mbrojtja Kombëtare e Kosovës”. Shqipëri: 1 maj 1918.

ministrit të Drejtësisë. Kjo pozitë e rëndësishme shtetërore, gërshetoi synimet politike të Komitetit të Kosovës me detyrat shtetërore. Kjo sepse, pikërisht Prishtina ishte ndër të parët e cila kërkoi që mbrojtja e të drejtave kombëtare të shqiptarëve të Kosovës dhe të viseve të tjera të pushtuara, të jetë bërthama e politikës së jashtme të Shqipërisë, si shtet i sapoformuar dhe me shumë probleme (të brendshme dhe të jashtme).⁷ Kjo ishte arsyeja që Beogradi zyrtar nuk rreshti së bëri kritika ndaj Tiranës, duke e akuzuar se mbështetë Komitetin e Kosovës, që kishte synime për shkëputjen e Kosovës dhe të viseve të tjera të pushtuara, nga Mbretëria SKS.

Komiteti i Kosovës nuk rreshti së bëri përpjekje në mbrojtje të Shqipërisë dhe territoreve shqiptare që ishin jashtë kufijve të saj. Për këtë dëshmon raporti që ky komitet më 20 dhjetor 1918, ia dërgoi Ministrisë së Punëve të Jashtme në Londër, në të cilën janë përshkruar masakrat që forcat serbe i kanë kryer mbi popullsinë shqiptare të rajonit të Rekës, që ndodhet në mes të Pejës dhe Gjakovës dhe rajonit të Llapit dhe Gollapit, që ndodhen në regjionin e Prishtinës. Anëtarët e Komitetit të Kosovës kërkonin nga Londra zyrtare që të ndërmerre një masë vendimtare, që do të arrinte të ndalonte shkatërrimin e plotë të Kosovës. Andaj, është e nevojshme një ndërhyrje e shpejtë ushtarake nga ana e Fuqive të Mëdha aleate, që do të çonte në vendosjen e një protektorati ndërkombëtar në gjithë territorin e Kosovës.⁸ Vetëm në harkun kohor nga 22 shkurt deri më 23 mars 1919, Komiteti i Kosovës ka përgatitur dhe i ka dërguar Londrës zyrtare një varg raportesh, kërkesa e statistika të ndryshme, nëpërmjet të cilave e ka njoftuar atë për masakrat e forcave serbe mbi shqiptarët e krahinave të Plavës, Gucisë, Pejës, Gjakovës, Rugovës dhe vendbanimeve të tjera shqiptare.⁹

Vlen të përmendet telegrami që Komiteti i Kosovës u ka dërguar Fuqive të Mëdha gjatë muajit prill 1919, nëpërmjet të cilit kërkonte që të ruheshin të drejtat kombëtare të shqiptarëve të Kosovës. Në këtë telegram më tej thuhet që: *“Kosova padrejtësisht është pushtuar nga serbët në luftërat ballkanike (dhe ripushtuar më 1918), por megjithatë 90% e popullsisë së saj janë shqiptarë”*.¹⁰ Krahës telegrameve të sipërshënuar, natyrisht që Komiteti i Kosovës bashkëpunoi me krahun ushtarak të lëvizjes çlirimtare të Kosovës, gjegjësisht me Lëvizjen Nacionalçlirimtare Kaçake,

⁷ Meta et.al, *Historia e shqiptarëve*, 611.

⁸ Ethem Çeku, Bejtulla Destani, *Gjeneral G. F. Phillips dhe Komiteti “Mbrojtja Kombëtare e Kosovës”*, Dokumente historike nga Arkivat Britanike, 1913-1921, Tiranë: Instituti i Çështjeve Kombëtare-Tiranë dhe Qendra për Studime Shqiptare-Londër, 2015, 232-233.

⁹ Çeku dhe Destani, *Gjeneral G.F. Phillips*, 299-245 dhe 351-371.

¹⁰ ASHAK, F. Komiteti Mbrojtja Kombëtare e Kosovës, V.1919, Sigla II, Mikrofilmi. 410-211, fl. 9. Një telegram tjetër, prill 1919.

gjatë gjithë periudhës së veprimtarisë së tij. Këtë e vërteton fakti që të gjithë udhëheqësit e çetave në Kosovë u vunë nën urdhrat e Hasan Prishtinës, Bajram Currit, Bedri Pejani dhe udhëheqës të tjerë politikë të Komitetit.¹¹

Komiteti i Kosovës ka bashkëvepruar me parinë e Plavë-Gucisë dhe Rugovës dhe të dyja palët kanë mbështetur pa rezerva njëra-tjetrën. Këtë bashkëpunim intensive mundësonte edhe afërsia e këtyre krahinave me Shkodrën, andaj në këto vise u krijua ndër të parat degë të Komitetit, në viset jashtë kufijve të 1913. Komiteti i Kosovës hapur bashkëpunonte me parinë e viseve të sipërpërmendura, të cilat njëzëri ishin për të kundërshtuar me armë rivendosjen e sundimit serbo-malazez. Madje, në përpjekje për të ndihmuar këto krahina në Kryesinë e Komitetit ishte dërguar si përfaqësues i krahinës së Plavë-Gucisë, Ismail Haki Nikoçi, i cili bënte përpjekje që të ndërkomëtarizonte çështjen e këtyre krahinave pranë përfaqësuesve të Fuqive të Mëdha të vendosura në Shkodër. Sipas një aktpërfaqësimi nga populli i këtyre viseve, që i është dërguar Kryesisë së Komitetit të Kosovës më 24 dhjetor 1918, shprehej hapur dëshira për: “Bashkimin e Plavë-Gucisë me Shqipërinë e lirë vetqeveritare”. Natyrisht që ky përcaktim sfidues për Beogradin, nxiti edhe krahinën e Rugovës dhe të viseve të tjera të hidheshin në kryengritje, me qëllim çlirimin dhe bashkimin me Shqipërinë.¹²

Pikëpamja që e ka paraqitur delegacioni i qeverisë së Durrësit në Parisë, më 12 shkurt 1919, për korrigjimin e vendimeve të Konferencës së Ambasadorëve në Londër më 1913, dhe për krijimin e Shqipërisë etnike, alarmoi diplomacinë jugosllave, andaj Beogradi përshejtoi vendosjen e kontrollit mbi Plavën, Gucinë e Rugovën.¹³ Në këto rrethana kërcënuese për territoret shqiptare, u përgatit kryengritja e vitit 1919*, nga Komiteti i Kosovës, me anë të: “Programit të përgjithshëm të kryengritjes në Kosovë, më 1919”, program i cili përbëhej nga 10 pika.¹⁴ Për këtë kryengritje,

¹¹ Liman Rushiti, “Lëvizja Kaçake dhe Komiteti Mbrojtja Kombëtare e Kosovës”, në *Komiteti “Mbrojtja Kombëtare e Kosovës”* (Përmbledhje kumtesash), Tiranë: Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Historisë-Tiranë, Instituti i Historisë-Prishtinë: 2004, 93.

¹² Meta et.al, *Historia e shqiptarëve*, 614-618.

¹³ Meta et.al, *Historia e shqiptarëve*, 618.

* Për më tepër për kryengritjen e Plavës dhe të Gucisë më 1919 shih në: Lush Culaj, “Komiteti i Kosovës dhe kryengritja e Plavës dhe e Gucisë e vitit 1919”, në *Kumtime historike II* (Materiale nga tryeza shkencore: Shekulli i Komitetit Mbrojtja Kombëtare e Kosovës 1918-2018), Prishtinë: Instituti Albanologjik dhe Instituti Kosovar për Studime Sociale “Gnosis”, 2021, 9-19.

¹⁴ Sabile Keçmezi-Basha, “Karakteri kombëtar e demokratik i programeve të Komitetit Mbrojtja Kombëtare e Kosovës (MKK)”, në Kosova, Nr.42/2017, 187.

Nikolla Pashiqi, që ishte në Konferencën e Paqes në Paris, shprehej se kryengritja shqiptare duhej të shuhet gjithsesi. Pas dhunës dhe reprezaljeve që rifilluan në Kosovë nga forcat serbo-malazeze, të cilat kryen krime të rënda, (qindra të vrarë, në mesin e të cilëve gra, fëmijë e pleq dhe mbi 120 fshatra të shkatërruara), kjo kryengritje u shua më 10 qershor 1919, duke lënë pas dëme të mëdha njerëzore dhe materiale.¹⁵

Se Komitetit i Kosovës dhe krerët e saj, si Hasan Prishtina, Kadri Prishtina, Azem Bejta etj., punonin në koordinim me Shqipërinë dhe Italinë, për zgjerimin e kryengritjes në qarkun e Prizrenit, të Dukagjinit dhe të Kosovës, mësojmë nga një relacion që ministri i Punëve të Brendshme të Mbretërisë SKS, ia kishte dërguar ministrit të ushtrisë, në të cilin ndër të tjera thuhet se: “*Azem Bejta po punonte me udhëzime nga Shqipëria*”.¹⁶

Komiteti i Kosovës, përveç bashkëpunimit me krahun ushtarak, kishte si detyrë mbrojtjen e çështjes shqiptare në Konferencën e Paqes në Paris (1919-1920), ngase rrezikohej copëtimi edhe më tej i kufijve politikë të Shqipërisë së 1913. Veprimtarët e Komitetit të Kosovës e dinin se copëtimi i mëtejshëm i Shqipërisë ishte fatal edhe për Kosovën dhe viset e tjera shqiptare. Duke e ndjerë këtë rrezik për çështjen shqiptare, Komiteti i Kosovës ishte për një konferencë ku do të definohej dy pika kryesore: së pari, të definohej statusi i ardhshëm i Kosovës dhe së dyti, të caktohej administrimi i brendshëm i saj.¹⁷

Edhe pse në fillim e mbështeti delegacionin zyrtar shqiptar, Komiteti i Kosovës caktoi një delegacion për në këtë konferencë, prej tre anëtarësh me në krye Hasan Prishtinën, për të mbrojtur të drejtat e shqiptarëve të Kosovës dhe të viseve të tjera shqiptare në Mbretërinë SKS. Qëndrimi i tij prej një diplomati largpamës dhe proitalian, për të siguruar përkrahjen e diplomacisë italiane, nuk i pëlqente aspak qeverisë jugosllave, e cila e konsideronte atë si italofil dhe patriot të madh.¹⁸ Komiteti i Kosovës nuk e ndali për asnjë moment veprimtarinë e tij në të mirë të çështjes shqiptare. Kështu, më 24 prill 1919 nga Shkodra i bëri thirrje popullit shqiptar të Kosovës dhe kërkonte nga ai që të aktivizohen për çlirimin dhe bashkimin e viseve shqiptare me shtetin amë. Në këtë thirrje, më tej thuhet:

¹⁵ Rushiti, “Lëvizja Kaçake dhe Komiteti”, 97-98; Meta et.al, *Historia e shqiptarëve*, 622.

¹⁶ Hakif Bajrami, *Kosova 1918-1941*, Prishtinë: autori, 2018, 101.

¹⁷ Asllan Krasniqi, “Rrafshi i Dukagjinit gjatë Mbretërisë SKS (1918-1929)”, (I pabotuar, Departamenti i Historisë, Universiteti i Prishtinës, 2005), 25.

¹⁸ Lush Culaj, “Veprimtaria e Komitetit “MKK” për ndërkombëtarizimin e çështjes shqiptare”. *Komiteti “Mbrojtja Kombëtare e Kosovës”*, (Përmbledhje kumtesash), Tiranë: Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Historisë-Tiranë, Instituti i Historisë-Prishtinë, 2004, 52-54.

“Qeveria e Beogradit po fuste çeta në Shqipëri kundër qeverisë tonë dhe po shkaktonte trazira [...]”.¹⁹ Për më tepër, në verën e vitit 1919, kur forcat serbe futeshin në Shqipërinë e Veriut, Komiteti i Kosovës nëpërmjet një udhëzimi, të datës 25 gusht 1919, dënoi përpjekjet e vazhdueshme të Mbretërisë SKS për t’u shtrirë më tej në territorin e shtetit shqiptar, konkretisht drejt Malësisë së Shkodrës.²⁰ Por, njëkohësisht nëpërmjet këtij udhëzimi Komiteti i Kosovës u rekomandonte degëve dhe veprimtarëve të tij të mos i acaronin marrëdhëniet me serbët dhe fqinjët e tjerë dhe kësisoj të shmangnin përplasjet me forcat e tyre ushtarake. Kjo kërkesë bëhej për të pasur kujdes së paku deri në vendimet e Konferencës së Paqes në Paris, në lidhje me kufijtë e Shqipërisë.²¹

Komiteti i Kosovës, me veprimtarinë e tij pati ndikim gjatë gjithë viteve të veprimtarisë së tij në jetën politike të Shqipërisë dhe natyrisht në marrëdhëniet e saj me shtetet fqinje, në veçanti me Mbretërinë SKS. Për të parë këtë ndikim, do të veçojmë këtu udhëzimet e datës 18 janar 1920, që Komiteti ua jepte delegatëve të tij në Kongresin e Lushnjës: *“Qeveria e Durrësit qe 13 muaj, nuk ka marrë kurrfarë mase për lirimin e Kosovës, ku banojnë mëse 900 mijë bashkëkombës [...]”*. Prandaj, sugjeronte Komiteti, në një aktproteste dërguar Fuqive të Mëdha e Kryesisë së Konferencës së Paqes, do të duhej jo vetëm një Shqipëri e pavarur, por edhe bashkimi i krahinave të Kosovës, të Manastirit, të Çamërisë e të Ulqinit, që më 1913 mbetën nën Serbinë, Malin e Zi dhe Greqinë”.²² Prandaj, vendimet e Kongresit të Lushnjës, shkaktuan shqetësim në Beograd, ngase vendosmëria e delegatëve të këtij kongresi për të kërkuar jo vetëm një Shqipëri në kufijtë e 1913, por edhe bashkimin e të gjitha pjesëve të saj në kuadër të shtetit shqiptar, ishte e papranueshme për politikën zyrtare jugosllave.²³

¹⁹ Krasniqi, “Rrafshi i Dukagjinit”, 59.

²⁰ Kristaq Prifti, “Kontributi i Komitetit “Mbrojtja Kombëtare e Kosovës” për rimëkëmbjen e pavarësisë së Shqipërisë dhe për bashkimin kombëtar (1918-1924)”, në *Komiteti “Mbrojtja Kombëtare e Kosovës”* (Përmbledhje kumtesash), Tiranë: Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Historisë-Tiranë, Instituti i Historisë-Prishtinë: 2004, 21.

²¹ Prifti, “Kontributi i Komitetit “Mbrojtja Kombëtare e Kosovës”, 22.

²² Xheladin Shala, “Roli i Komitetit Mbrojtja Kombëtare e Kosovës” në luftërat shqiptaro-serbe gjatë viteve 1918-1921”, në *Komiteti “Mbrojtja Kombëtare e Kosovës”* (Përmbledhje kumtesash), Tiranë: Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Historisë-Tiranë, Instituti i Historisë-Prishtinë 2004, 119-120.

²³ Shala, “Roli i Komitetit Mbrojtja Kombëtare e Kosovës”, 120.

Megjithë tensionet në marrëdhëniet shqiptaro-jugosllave, Tirana zyrtare kërkonte nga Beogradi që me anë të marrëveshjes t'i lëshonte paqësisht territoret e pushtuara brenda kufijve të 1913, tërheqjen e ushtrisë jugosllave dhe ndërprerjen e ndihmës për bandat e organizuara përgjatë kufirit shqiptaro-jugosllav. Mirëpo, për palën jugosllave ishte e papranueshme dhe njëkohësisht e pamundur të arrihet një marrëveshje, ngaqë në qeverinë e Tiranës ishin personalitetet si Hoxha Kadri Prishtina e Bajram Curri, që njëkohësisht ishin udhëheqës dhe veprimtarë të shquar të Komitetit të Kosovës.²⁴ Pra, në marrëdhëniet shqiptaro-jugosllave, edhe ashtu të acaruar, ka pasur ndikim të madh edhe zgjedhja e Hoxhë Kadri Prishtinës në pozitën e ministrit të Drejtësisë në qeverinë e Lushnjës dhe Bajram Currit (ministër pa portofol), fakt që ishte i papranueshëm për politikën zyrtare jugosllave.²⁵

Zgjidhjen e problemit të Kosovës dhe të viseve të tjera shqiptare në Mbretërinë SKS, dhe tërheqjen e forcave jugosllave nga territoret e pushtuara brenda Shqipërisë së 1913 nëpërmjet marrëveshjes Tiranë-Beograd e shihte të pamundur edhe Komiteti i Kosovës. Krerët e saj duke e parë çështjen e çlirimit të Kosovës dhe të viseve të tjera si problem të Shqipërisë, ngase ishin pjesë e saj deri më 1913, e pamundësuan jetësimin e politikës jugosllave për të hyrë në marrëveshje me çfarëdo element antishqiptar, që do të ndikonte më pas jo në zgjidhjen e problemit të Kosovës, por në copëtimin e mëtejme të saj. Vlen të përmendet letra e 3 janarit 1920, të cilën Komiteti i Kosovës ia drejtoi parisë së Malësisë së Madhe e të Kosovës, në të cilën shkruan se: *“kurrkush, pos një qeverie thjesht kombëtare e atdhetare të Shqipërisë nuk ka me pas të drejtë me u marrë vesh me Serbinë, duke pranuar të marrë vetëm Pejën, Gjakovën e Prizrenin dhe për të sakrifikuar krahinat e tjera të Kosovës”*. Andaj, i vendosur për të mbrojtur tërësinë e Kosovës, ky komitet e siguronte parinë e Kosovës se: *“çdo marrëveshje me serbët që bie ndesh me tërësinë tokësore të Kosovës duhet kundërshtuar”*.²⁶

Anëtarët e Komitetit të Kosovës kishin të drejtë të frikësoheshin, për faktin se zgjidhjen e çështjes shqiptare, e shihnin ndryshe nga qeveria e Lushnjës. Kështu, derisa Komiteti i Kosovës mendonte se kishte ardhur koha për çlirimin e Kosovës, në anën tjetër qeveria shqiptare mendonte se parasë gjithash duhet të sigurohen njëherë kufijtë e njohur dhe të pranuar nga Fuqitë e Mëdha, ngase veprimet e nxituara mund të sillnin pasoja të

²⁴ Shala, “Roli i Komitetit Mbrojtja Kombëtare e Kosovës”, 121.

²⁵ Culaj, *Komiteti Mbrojtja Kombëtare e Kosovës*, 40.

²⁶ Prifti, “Kontributi i Komitetit Mbrojtja Kombëtare e Kosovës”, 30-31.

parikuperueshme. Mbase, kishte më tepër të drejtë qeveria shqiptare që frikësohej, kur dihej fakti se në kufirin ndërmjet Shqipërisë dhe Kosovës kishte një mobilizim tepër të madh të forcave jugosllave (70 000 veta).²⁷

Në anën tjetër, për palën jugosllave, siç shkruhej në të përditshmen “Politika”, të datës 3 shtator 1920, *“çështja shqiptare nuk është vetëm problem i politikës së jashtme, ajo është në të njëjtën kohë edhe problem i brendshëm. Në kufijtë tanë jeton një numër bukur i madh shqiptarësh, gati sa bashkatdhetarët e vet [...]”*.²⁸

Duke e parë rrezikun si pasojë e pa përcaktimit të vijës kufitare ndërmjet Shqipërisë dhe Mbretërisë SKS dhe në përpjekje për të zgjidhur çështjen e shqiptarëve në Kosovë dhe në viset e tjera shqiptare të kësaj mbretërie, qeveria e Lushnjës shpresonte që në rrugë diplomatike dhe në marrëveshje me jugosllavët të zgjidhte çështjet e sipërshënuara. Andaj, me iniciativë të qeverisë së Tiranës, në fund të shtatorit të vitit 1920, në Shkodër filluan bisedimet shqiptaro-jugosllave, të cilat me disa ndërprerje vazhduan për disa muaj. Pala jugosllave, krahas kërkesave të saj, ankohej se në Shkodër ekzistonte Komiteti i Kosovës, kryetari i së cilit ishte anëtar i qeverisë së Tiranës, se në Shqipëri ndodheshin e vepronin për të përgatitur revolucionin në Kosovë Hasan Prishtina, Bajram Curri etj. Qeveria shqiptare duke dashur të arrinte marrëveshje me palën jugosllave, gjithnjë sipas interesave të saj, njoftoi Beogradin se ajo kishte ndaluar veprimtarinë e Komitetit të Kosovës në Shkodër.²⁹ Kësisoj, Shqipëria bënte përpjekje të vazhdueshme për të arritur një marrëveshje me Mbretërinë SKS. Vetëm gjatë muajit prill të vitit 1921, qeveria shqiptare ka dërguar në Beograd, tri herë radhazi një delegacion të kryesuar nga gjenerali Ali Riza Pasha Kolonja, mirëpo, të gjitha këto përpjekje rezultuan pa sukses, ngase pala jugosllave i injoroi të gjitha propozimet e palës shqiptare.³⁰

Por, krahas përpjekjeve diplomatike, qeveria shqiptare fshehtas përkrahte edhe iniciativat për kryengritje, që ndërmerreshin nga shqiptarët. E tillë ishte kryengritja e armatosur e patriotëve dibranë, me në krye Elez Isufin, që u zhvillua kundër pushtuesve jugosllavë. Kjo kryengritje filloi nga mesi i gushtit të vitit 1920, ndërsa pas zhvillimit të betejave të fuqishme, kryengritësit arritën ta çlironin Peshkopinë, duke detyruar kështu ushtrinë jugosllave të tërhiqej në kufirin e 1913. Me gjithë suksesin e arritur të kryengritësve dibranë, jugosllavët jo vetëm që nuk u pajtuan me humbjen e

²⁷ Shala, “Roli i Komitetit Mbrojtja Kombëtare e Kosovës”, 123.

²⁸ Shala, “Roli i Komitetit Mbrojtja Kombëtare e Kosovës”, 124; Culaj, *Shqipëria*, 96.

²⁹ Paskal Milo, *Politika e jashtme e Shqipërisë I*, Tiranë: Toena, 2013, 495-497.

³⁰ Joseph Swire, *Shqipëria ngritja e një mbretërie*, Tiranë: Dituria, 2005, 277.

tyre, por më 2 shtator rifilluan sulmin, ndërsa një ditë më pas arritën ta ripushtojnë Peshkopinë dhe vazhduan marshimin duke mos u ndalur as para “vijës strategjike”, në thellësi të vendit. Më 26 tetor ushtria jugosllave pushtoi Lurën, Oroshin etj., ndërsa një pjesë tjetër e saj hyri në Shëngjin, Lezhë e deri afër Tiranës. Beteja vendimtare ndërmjet kryengritësve dibranë dhe ushtrisë jugosllave u zhvillua më 28 tetor 1921 në vendin Lana e Lurës, ku forcat jugosllave u detyruan të tërhiqeshin dhe t’i zinin pozicionet në brigjet lindore të Drinit të Zi. Duke u frymëzuar nga sukseset që patën kryengritësit dibranë, u gjallërua edhe rryma irredentiste kosovare, që përfaqësohej nga Komiteti i Kosovës, i cili tanimë nuk kërkonte vetëm çlirimin e tokave shqiptare brenda kufijve të vitit 1913, por synonte edhe çlirimin e Kosovës, nëpërmjet kryengritjes së armatosur. Për të arritur këtë qëllim, Komiteti i Kosovës angazhoi Bajram Currin, që t’i siguronte armët dhe municionin. Në gusht të vitit 1920, Curri arriti të siguronte disa ndihma nga italianët që kapnin shumë 30 milionë franga. Por, papritmas u doli një problem me qeverinë e Tiranës, e cila mori vendim që të ndalonte shkarkimin në Shëngjin të 20 000 pushkëve të sjella nga D’Annunzio për kryengritësit e Kosovës. Një vendim i tillë, sipas qeverisë shqiptare erdhi për së paku dy arsye: 1. Për shkak se nuk gjykonte të përshtatshme rrethanat për ta ndërmarre një veprim të tillë, i cili mund të sillte ndërlikime ndërkombëtare në dëm të Shqipërisë dhe 2. Për shkak të frikës nga Mbretëria SKS, e cila mund të ndërmernte ndonjë aksion të përmasave të gjera kundër Shqipërisë, që mund ta vinte në dyshim ekzistencën e saj, si shtet i pavarur.³¹

Komiteti i Kosovës nuk rreshti së kërkuari ndërhyrjen nga Fuqitë e Mëdha, në veçanti nga Britania e Madhe, për të ndalur krimet e forcave serbe ndaj shqiptarëve në Mbretërinë SKS. Po përmendim një raport të statistikave të datës 3 prill 1921, mbi gjendjen e shqiptarëve në Kosovë, që Komiteti i Kosovës ia ka paraqitur Konferencës së Paqes në Paris dhe qarqeve diplomatike të Fuqive të Mëdha. Me anë të kësaj shkrese përshkruhej gjendja e rëndë e shqiptarëve, si pasojë e dhunës dhe terrorit që pushteti i Beogradit ushtronte ndaj tyre. Më tej, me anë të kësaj shkrese kërkohej nga Fuqitë e Mëdha të ndërhynin për të ndaluar vazhdimin e terrorit dhe për të parandaluar spastrimin etnik në Kosovë, ngase siç thuhet: *“Po të lehen serbët të veprojnë ashtu si e kanë nisë, brenda pesë e deri dhjetë vjet, ka me mbetë një popullsi shumë e pakët nga shqiptarët qi*

³¹ Culaj, *Shqipëria*, 95-97.

përmbajnë nandë dhjetë të qindat e Kosovës (90% të popullsisë së Kosovës)”.³²

Komiteti i Kosovës për të ndërkombëtarizuar çështjen e Kosovës më 10 prill 1921 ia dërgoi një shkresë edhe Ministrisë së Punëve të Jashtme të Britanisë së Madhe, nëpërmjet së cilës e informonte mbi dhunën dhe terrorin që ushtria serbe kishte bërë ndaj popullsisë shqiptare. Veçohej fakti se vetëm brenda dy javëve, në regjionin e Prishtinës, janë vrarë më shumë se 3 800 persona, prej të cilëve shumë fëmijë, gra dhe pleq. Për krimet e lartshënuara, Komiteti i Kosovës ndër të tjera shprehej: *“Robëritë e grave dhe fëmijëve, të kryera në mes të Evropës, nga autoritetet serbe dhe masakrat e kryera prej tyre, kundër mijëra (shqiptarëve) të pafajshmëve, përbëjnë një turp për qytetërimin e shekullit XX”*.³³ Po ashtu, për të pasqyruar gjendjen e rëndë të shqiptarëve në Mbretërinë SKS, Komiteti i Kosovës më 2 dhjetor 1921 i dërgoi një letër edhe Komisionit të Lidhjes së Kombeve, në të cilën, ndër të tjera, thuhet: *“qeveria serbe në nëntë vitet e fundit ka kaluar shumë herë kufirin e 1913-tës dhe vijën e demarkacionit. Po ashtu ka vrarë dhe masakruar 1392 shqiptarë, në mesin e të cilëve gra, fëmijë dhe pleq, ka djegur 1725 shtëpi dhe ka shpërngulur 4275 qytetarë shqiptarë nga krahinat si Batusha, Gashi, Krasniqja, Bytyqi, Hasi, Reka e Keqe, Vuthaj etj.*³⁴

Për çështjen e Kosovës dhe të viseve të tjera shqiptare në Mbretërinë SKS, që në krye të herës ofruam të dhëna që dëshmojnë përpjekjet e vazhdueshme të Komitetit të Kosovës, në veçanti të anëtarëve më të njohur të saj, si: Hasan Prishtina, Kadri Prishtina, Bajram Curri etj.* Kjo ishte arsyeja që për qeverinë e Beogradit, veprimtaria e Komitetit të Kosovës ishte bërë problem tejet i madh dhe kësioj pengesë e pakapërcyeshme në marrëdhëniet shqiptaro-jugosllave. Andaj, jo vetëm që nuk u arrit asnjë marrëveshje me palën shqiptare, por qeveria jugosllave vazhdoi qasjen destruktive në raport me Shqipërinë. Për më tepër, me gjithë masat e

³² ASHAK, F. Komiteti Mbrojtja Kombëtare e Kosovës, V. 1921, Sigla II, Mikrofilmi 708-833, fl. 500. Raporte dhe statistika që Komiteti i Kosovës ia ka parashtruar Konferencës së Paqes në Paris dhe qarqeve diplomatike të Fuqive të Mëdha, 3 prill 1921.

³³ Çeku dhe Destani, *Gjenerali G.F. Phillips*, 432-433.

³⁴ ASHAK, F. Komiteti Mbrojtja Kombëtare e Kosovës, V. 1921, Sigla II, Mikrofilmi 708-811. Të shkëlqyeshmit Komision, të Ligës së Kombeve, Tiranë, më 2 dhjetor 1921.

* Me nismën e Hasan Prishtinës, Bajram Currit dhe veprimtarëve të tjerë nga 18 janar 1919 deri më 21 janar 1920 nga Komiteti i Kosovës iu dërguan Konferencës së Paqes në Paris, tri parashtrës, në të cilat kërkohej që viset e ish-vilajetit të Kosovës, që historikisht ishin pjesë përbërëse e Shqipërisë, të shkëputeshin nga Mbretëria SKS dhe t'i bashkoheshin Shqipërisë. Për më tepër shih: *Historia e popullit shqiptar*, Vëll. III, 459.

ndërmarra nga qeveria e Ahmet Zogut ndaj anëtarëve të Komitetit të Kosovës si heqja e mandateve të deputetëve të Drinit, udhëheqësve të Komitetit të Kosovës etj., Beogradi prapë nuk kishte besim në qeverinë shqiptare. Madje, autoritetet jugosllave shprehnin dyshimin, se lufta në mes të Zogut dhe të Komitetit të Kosovës është një lloj demonstrimi në formë të mashtrimit të fqinjëve të tyre, në këtë rast të Mbretërisë SKS. Ky dyshim pasqyrohet, nga një raport i Komisionit të Punëve të Brendshme, që mban datën 31 korrik 1922, ku ndër të tjera theksohet: *“Komiteti i Kosovës tani për tani do t’i shërbejë qeverisë së Tiranës për të njëjtat qëllime, sikurse ai i maqedonasve që i shërben qeverisë bullgare, që sa për formë do t’i ndjekin kurse në të vërtetë do t’i ndihmojnë me të gjitha mjetet e mundshme materiale dhe morale që të na shqetësojnë qoftë me trazira kufitare ose me kryengritje të popullit në territorin tonë (në Kosovë dhe në viset e tjera shqiptare në Jugosllavi)”*.³⁵

Komiteti i Kosovës, për shkak se ishte i interesuar për një Shqipëri të fortë dhe demokratike, që do të interesohej në vazhdimësi për çështjen e Kosovës, u përfshi në konfrontimin politik në Shqipëri. Në prag të Revolucionit të Qershorit 1924, ai përkrahu opozitën demokratike edhe pse nuk kemi të dhëna të sakta se cilat çeta dhe sa luftëtarë u angazhuan drejtpërdrejt në luftimet e qershorit. Mirëpo, dihet mirëfilli se roli i Hasan Prishtinës, Bajram Currit e personaliteteve të tjera të Komitetit, ishte i pakontestueshëm.³⁶ Gjatë qeverisjes së Nolit, ndikimi i Komitetit të Kosovës në marrëdhëniet shqiptaro-jugosllave ishte tejet i madh. Kjo, ngase kryeministri shqiptar duhej të zgjidhte njërën nga dy rrugët, që nuk mund të ndiqeshin paralel: ose duhej të kishte marrëdhënie të mira me Mbretërinë SKS, që ishin shumë të nevojshme, ose duhej të mbronte interesat e shqiptarëve të Kosovës dhe të viseve të tjera shqiptare, të cilat i proklamonte Komiteti i Kosovës. Noli zgjodhi rrugën e dytë, pra mbështetjen e Komitetit të Kosovës, ndonëse ishte i vetëdijshëm për pasojat që do t’i kishte më pas. Ky qëndrim bëri që marrëdhëniet e qeverisë së tij me qeverinë e Beogradit të jenë thuajse të ngrira, si rezultat i akuzave dhe kundër akuzave, për çështjen e shqiptarëve në Kosovë dhe në viset e tjera në Mbretërinë SKS. Si pasojë e kësaj qasjeje, qeveria jugosllave jo vetëm që nuk e njohu qeverinë e Nolit, por bëri përpjekje në vazhdimësi për rrëzimin e tij. Kjo është arsyeja që Ahmet Zogu, duke qenë i strehuar në Beograd dhe i mbështetur nga

³⁵ Culaj, *Komiteti Mbrojtja Kombëtare e Kosovës*, 121.

³⁶ Rushiti, “Lëvizja Kaçake dhe Komiteti”, 101.

jugosllavët, u dakordua që pas rikthimit të tij në Tiranë, të shkatërrojë Komitetin e Kosovës dhe Lëvizjen Kaçake.³⁷

Pas rikthimit të Zogut në pushtet, diplomacia jugosllave filloi të besojë më tepër se qeveria në Tiranë do të pengojë veprimtarinë e Komitetit të Kosovës dhe të Lëvizjes Kaçake, e cila tashmë kishte marrë një goditje të fuqishme me vrasjen e prijësit të saj, Azem Galicës. Këtë e mësojmë nga një shkresë që i dërgohet Ahmet Zogut nga legata shqiptare në Beograd më 21 maj 1925, në të cilën jepen të dhëna se rreth kufirit shqiptaro-jugosllav janë formuar banda kaçake. Më tej, thuhet që: *“këto banda kaçakësh, thonë këta, formohen në të përmendunën Lumë, tinëz dhe me vërejtje të mëdha nga ana e zyrtarvet, të cilët gjithashtu po bajnë do përgatitje për me e dliur shtetin prej këtyre bandave qi janë të rrezikshme si për shtetet fqëj ashtu edhe për Shtetin Shqiptar, po sado për me muejt ky me mbet mik me Shtetet fqëj”*.³⁸ Më tej, në këtë dokument tejet me rëndësi, thuhet se kaçakët përbëhen nga shqiptarët e Shqipërisë, të cilët ishin të pakënaqur dhe nga shqiptarët e Kosovës dhe të viseve të tjera shqiptare në Mbretërinë SKS, që ishin të shpërngulur nga ushtria serbe dhe ishin vendosur në Shqipëri. Ata ndihmoheshin nga Komiteti i Kosovës, i cili sipas serbëve punonte në mënyrë të fshehur në Mbretërinë SKS.³⁹ Pra, sipas Ambasadës shqiptare në Beograd, pala jugosllave ishte e bindur që kaçakët dhe veprimtarët e Komitetit të Kosovës ndiqeshin zyrtarisht nga ana e qeverisë së Tiranës.

Duhet të theksohet fakti se megjithë rrethanat gjithnjë më të vështira, një detyrë tejet e rëndësishme e Komitetit të Kosovës ishte edhe *sigurimi i të drejtave politike e shoqërore* të bashkëkombësve mbetur në Kosovë duke iu drejtuar Fuqive të Mëdha, detyrë që ishte precizuar në pikën D të Detyrave të Komitetit, formuluar në fillim të vitit 1921.⁴⁰ Për këtë arsye, Komiteti sensibilizoi faktorin ndërkombëtar, me anë të letrave, të

³⁷ Robert C. Austin, *Fan Noli dhe një revolucion i ikur. Demokracia shqiptare në vitet, 1920-1924*, Prishtinë: Koha, 2011, 332.

³⁸ Arkivi i Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme (më tej: AMEPJ), Fondi. (më tej: F.) 152, Viti. (më tej: V.) 1925, Dosja. (më tej: D.) 112, fl. 102. Letër nga Ambasada e Shqipërisë në Beograd dërguar kryetarit Ahmet Zogu me titull: Komiteti i Kosovës në punë e sipër, më 21 maj 1925.

³⁹ AMEPJ, F. 152, V. 1925, D. 112, fl. 102. Letër nga Ambasada e Shqipërisë në Beograd dërguar kryetarit Ahmet Zogu me titull: Komiteti i Kosovës në punë e sipër, më 21 maj 1925.

⁴⁰ Emine Arifi-Bakalli “Përpjekjet e Komitetit “Mbrojtja Kombëtare e Kosovës” për denoncimin e dhunës dhe mbrojtjen e të drejtave kombëtare e demokratike të shqiptarëve në Jugosllavi”, *Komiteti “Mbrojtja Kombëtare e Kosovës”* (Përmbledhje kumtesash), Tiranë: Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Historisë-Tiranë, Instituti i Historisë-Prishtinë, 2004, 32.

peticioneve, të memorandumeve, të artikujve të botuar, të kontakteve të drejtpërdrejta etj., drejtuar politikanëve, shoqërive ndërkombëtare-qeveritare e joqeveritare, Konferencës së Paqes në Paris dhe Lidhjes së Kombeve, për pozitën e vështirë të shqiptarëve në Mbretërinë SKS. Andaj, Komiteti i Kosovës kërkonte nga instancat relevante ndërkombëtare të bënë tryzni ndaj jugosllavëve, në mënyrë që shqiptarët të realizonin të drejtat e tyre elementare politike e demokratike, siç ishin e drejta për shkollë në gjuhën shqipe, e drejta e përdorimit të gjuhës amtare, e drejta e përdorimit të simboleve kombëtare, themelimi i institucioneve kulturore, liria e shtypit etj.⁴¹ Por për shkakun e mohimit të këtyre të drejtave, Hasan Prishtina ishte deklaruar për shtypin vjenez më 1927, që: *“Do të mbetem armik deri sa ky shtet t’u japë të drejtat e minoritetit miliona shqiptarëve në Kosovë dhe Maqedoni, të drejta që nuk janë njohur deri më sot”*.⁴² Ndonëse Komiteti i Kosovës u shua më 1925, veprimtaria e tij ka vazhduar në rrethana të reja. Kështu, në Vjenë të Austrisë u formua Komiteti për Çlirimin e Kosovës (KÇK), që mund të themi se ishte vazhdimësi e Komitetit të Kosovës.

Si përfundim: veprimtaria e Komitetit të Kosovës, pati ndikim tejet të madh në marrëdhëniet shqiptaro-jugosllave që nga themelimi i tij, ngase kërkesat e Tiranës zyrtare drejtuar Beogradit, që nxiheshin nga Komiteti i Kosovës bënë që pala jugosllave jo vetëm që të kundërshtojë me forcë dhe si rezultat t’i mohojë, por edhe të akuzojë Tiranën për nxitjen që ua bënë Komitetit të Kosovës.

Marrëdhëniet shqiptaro-jugosllave u acaruan edhe për shkak të veprimtarisë së Komitetit të Kosovës, i cili nëpërmjet delegacionit të tij, në Konferencën e Paqes në Paris, pasqyroi dhunën dhe masakrat e serbëve ndaj shqiptarëve. Këtë veprimtari e vazhdoi edhe më pas, çka bëri që pastaj përfaqësuesit jugosllavë dhe ata shqiptarë të përplasen nëpërmjet akuzave dhe kundër akuzave ndaj njëri-tjetrit. Në përgjithësi, dihet që Komiteti i Kosovës luajti rol të rëndësishëm në mbrojtjen e interesave të kombit e të shtetit shqiptar, kundër synimeve të shteteve fqinje, në mënyrë të veçantë kundër planeve e politikës së Beogradit.

⁴¹ Emine Arifi-Bakalli, *Çështje nga historia modern dhe bashkëkohore shqiptare*, Prishtinë: Instituti Albanologjik, 2011, 47.

⁴² Arifi-Bakalli “Përpjekjet e Komitetit Mbrojtja Kombëtare e Kosovës”, 34-35.

Skender LUTFIU

SUMMARY

THE IMPACT OF THE KOSOVO NATIONAL DEFENCE COMMITTEE OVER THE ALBANIAN-YUGOSLAV RELATIONS

In this paper we have comprehensively elaborated the impact that the Kosovo Committee had on Albanian-Yugoslav relations, which were fragile and unstable. Since its establishment the activities of the Kosovo Committee produced a great impact on the Albanian-Yugoslav relations, for at least three reasons: first - because the demands that official Tirana addressed to Belgrade, which were encouraged by the Kosovo Committee, pushed the Yugoslav side not only to oppose and deny them, but also to accuse Tirana for supporting the Kosovo Committee; second – the Kosovo Committee delegation to the Peace Conference in Paris reflected the violence and massacres that Serbs did against Albanians, a fact that prompted clashes between the Albanian and Yugoslav delegations; and third – due to the fact that the Kosovo Committee played an important role in protecting the interests of the Albanian nation and state, through requests, letters and reports sent to international institutions such as the League of Nations, the Paris Peace Conference and the Great Powers, particularly Great Britain.